

GJYATA SUPREME E KOSOVËS , kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Erdogan Haxhibeqiri, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Jelena Krivokapiq, anëtarë, në çështjen juridike të paditësve A. Sh. nga ..., dhe A. M. nga ..., të cilët me autorizim e përfaqëson S. R., av. nga ..., kundër të paditurës “Mc c. T. K. L.” F. e D. në Gjilan, të cilën e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve SCL P. në ..., objekti i kontestit shpërblimi i dëmit, duke vendosur sipas revizionit të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3849/14 datë 27.11.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 27 shkurt 2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3849/14 datë 27.11.2018.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3849/14 datë 27.11.2018, është refuzuar ankesa e të paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.214/2010 datë 17.6.2014, me të cilën është vendosur

“Nën pikën I të dispozitivit pjesërisht është aprovuar kërkesëpadia e paditësit A. Sh., për shumën prej 2,170 € dhe paditësit A. M. në shumë prej 1.952 € e që obligohet e paditura që këto shuma t’ia paguaj paditësve në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Është obliguar e paditura që paditësve, në emër të shpenzimeve procedurale , t’u paguaj në emër të përpilimit të paditëse 93 € dhe për 4 seanca shumën prej 540 €.

Mbi pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë, është refuzuar kërkesa e paditësve”

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë , në afatin ligjor ka ushtruar revizion e paditura, për shkak të shkeljeve thelbësore të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të dy aktgjykimet të gjykatave të instancës më të ulët të prishen dhe lënda t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur, sipas nenit 215 të LPK, ka gjetur se:

Revizioni e të paditurës është i pabazuar.

Në procedurë të zhvilluar pranë gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar se paditësit kanë lidhur kontratë me të paditurën për kultivimin e duhanit dhe obligimi i tyre ka qenë që të dorëzojnë duhanin të paditurës dhe se e paditura ka qenë detyruar të paguaj nga 3.10 € për kilogram. E paditura përveç stimulimit nga 80 € në muaj , nuk ka pranuar duhanin e kultivuar nga paditësit për çka paditësit kërkojnë që e paditura paditësit të parë t'i paguaj kompensimin për sasinë prej 1350 kg duhan ndërsa për paditësin e dytë për sasinë prej 1200 kg duhan. Gjykata e shkallës së parë ka dëgjuar dëshmitarin Sh. I. i cili ka qenë mbikëqyrësi i fermerëve për mbjelljen e rasantit dhe kultivimit të duhanit, dhe sipas deklaratës së tij është vërtetuar se paditësi A. Sh. ka pasur kontratë për 50 ari për kultivim të duhanit si dhe paditësi i dytë A. M. 50 ari, përkundër marrëveshjes e paditura nuk ka pranuar duhanin të cilin e kanë kultivuar paditësit. Deklarata e dëshmitari përgjigjet në tërësi në listën e prodhuesve të duhanit të cilën e ka përpiluar e paditura në vitin 2008.

Gjykata e shkallës së parë, në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike , ka detyruar të paditurën që paditësve t'u paguaj shumat e caktuara si në pikën I të dispozitivit duke marrë çmimin mesatar për kg prej 2,50 €. Gjykata e shkallës së parë ka gjetur se sipas marrëveshjes e paditura ka qenë e obliguar të pranojë sasinë e duhanit sipas marrëveshjes e për këtë arsye paditësit i A. ka qenë të detyruar të hedhi në arë dhe ka lëvruar dhe mbuluar me dhe duhanin e prodhuar, e këtë fakt kanë vërtetuar edhe dëshmitarët I.dhe V.M. Për paditësin A. këtë fakt e kanë vërtetuar edhe dëshmitarët e dëgjuar L. D. dhe M. J.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën ankimore ka gjetur se gjykata e shkallës së parë duke vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia është e bazuar. N., gjykata e shkallës së dytë gjen se për themelësia e kërkesëpadiës është e drejtë dhe e bazuar pasi që në bazë të nenit 148 par. 1 të LMD-së (1978), përcaktohet “kontrata krijon të drejta dhe detyrime për palët kontraktuese, ndërsa me dispozitën e neni 262 par. 1 parashihet “se kreditori në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbushë me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë mbi bazën e vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga ana e gjykatës

së shkallës së parë, drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar. Aktgjykimi i goditur sipas vlerësimit të kësaj Gjykate përmban arsye të mjaftuara për faktet relevante, të vlefshme për gjykim të drejtë të kësaj çështjeje juridike të cilën e pranon edhe kjo Gjykatë.

Gjykata Supreme e Kosovës i ka vlerësuar si të pabazuara thëniet e të paditurës të cekura në revizion se aktgjykimi i goditur është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 pika (n) të LPK-së, pasi që aktgjykimi i goditur nuk është përfshirë me shkelje të tilla të procedurës, nga arsyeja se dispozitivi i aktgjykimit është në pajtim me provat e administruara kur gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se ka ekzistuar raporti juridik në mes të paditësve dhe të paditurës për kultivimin e duhanit, ku paditësit kanë përmbushur detyrimet e tyre duke kultivuar duhanin në sipërfaqe të caktuara sipas kontratës, por e paditura nuk ka pranuar duhanin e kultivuar për çka paditësit kanë qenë të obliguar që sasi të mbjella t'i hedhin si mbeturinë. E paditura ka qenë e obliguar në bazë të nenit 144 dhe lidhur me nenin 262 të LMD-së që duhanin e kultivuar ta pranojë dhe të paguaj kompensimin paditësve.

Thëniet e revizionit se nuk është vërtetuar fakti se a është asgjësuar sasia e duhanit, nuk qëndron, nga fakti se, nga deklarata e dëshmitarëve të dëgjuar I. M. dhe V. M., është vërtetuar se, nga fakti se e paditura nuk i është përmbajtur marrëveshjes për pranimin e duhanit, paditësit kanë qenë të detyruar që duhanin ta hedhin në arë dhe atë e kanë lëvruar dhe mbuluar me dhe. Këtë fakt e kanë vërtetuar edhe dëshmitarët e dëgjuar L. D. dhe M. J. Prandaj, në mënyrë të padyshimtë është vërtetuar fakti se duhani i kultivuar dhe prodhuar nga paditësit është hedhur si mbeturinë.

Nga arsyet e dhëna më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 222 të LPK-së.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Rev.nr.40/19 datë 27 shkurt 2019

Kryetari i kolegjit,
Erdogan Haxhibeqiri